



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 282/1 Prot.

Vlorë më, 30.01. 2026

VENDIM

Nr. 9, datë 30.01.2026

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË ADMINISTRATORIT TË UNIVERSITETIT
"ISMAIL QEMALI", VLORE, PËR ÇELJEN E PROCEDURAVE PËR MARRJEN
ME QERA TË AMBIENTEVE ALTERNATIVE PËR ZHVILLIMIN E PROCESIT
MËSIMOR NË FAKULTETIN E SHËNDETIT, TË UNIVERSITETIT "ISMAIL
QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 49 të Ligjit Nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 25 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; nenit 14 të Rregullores së Brendshme të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; nenit 6, pika 3, gërma f, e Rregullores financiare të UV-së; si dhe referuar propozimit të Administratorit ardhur me shkresën nr. 263 prot., datë 29.01.2026, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 29.01.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, përcjellë me shkresën nr. 263 prot., datë 29.01.2026, për celjen e procedurave për marrjen me qera të ambienteve alternative për zhvillimin e procesit mësimor në Fakultetin e Shëndetit; referuar kërkesës së Dekanit të Fakultetit të Shëndetit përcjellë me shkresën nr. 112 Prot., datë 26.01.2026.
2. Procedurat për marrjen me qera të ambienteve alternative do të fillojnë pas miratimit nga Rektorja e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, të kushteve dhe kriterëve që duhet të përmbushë godina që do të merret me qera për zhvillimin e procesit mësimor në Fakultetin e Shëndetit.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Rektori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe Administratori i UV-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Sotir NIKOLLA

